

E MARTA E MADHE

SHERBESA E DHENTERRIT II

Kjo shërbesë këndohet të Hënën e Madhe mbrëmëane. Këndimet vazhdojnë si në Shërbesën e Dhëntërrit I, gjer në fundin e Troparit të Dhëntërrit. Pastaj:

NDENJESORET

PAS O IPSOTHIS EN TO STAVRO.

T. IV. Eni e prisni Jesu Krishtin si Dhëntërr, dhe e nderoni me llambadhe gazmore, dhe me vërtuta ndritni dhe shkëlqeni kudo, si të urtat vajza silluni, dhe për dasmën gatituni, hyni tok me dhëntërrin, dhe u-shtroni në sofër, se dyke qënë Mbret dhe Perëndi, do tju dhuronjë kurorën e Engjëjve.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

PAS KATEPLLAJI IOSIF.

T. IV Një këshill' o Shpëtimtar, kundër teje plot me cmir, të paudhët priftërinj, edhe shkronjës të këqinj, në tradhësinë e shtynë Judën me argjende; përëndaj dhe ky, shkoj dhe u tha pa turp, pa besë dhe pa nder, si tregëtari në pazar: Ç' më jipni si çpërblim u tha, dhe

unë do t'jua shtie në duartë; nga tradhëti' e tij, faqezezë, ti shpëtona o Zoti Krisht.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

PAS TIN SOFIAN KE LOGON.

T. T. IV. Për argjëndin e murmë Juda u-err, edhe vetë Jesunë e tradhëtoj; i prapi këshillë bën, dhe mejtohet për dorëzim, bie jashtë dritës, midis të mallkuarve, merret vesh për shitjen, e shet të paçmuarin: përandaj i ligu, si çpagim për sa bëri, gjen varrje të turpshime, edhe vdekje të dhëmpshime; na shpëto nga dënim' i tij, o Krisht Perëndi dhe Zot, dhe dhurona ndjesën e mëkatave, ne që me mall po kremtojmë, Pësimet e hidhura.

LAVDI DHE TANI. *Gjithajo.*

UNGGJILLI PAS MATTHEUT

Më atë kohë, Farisianët bënë këshillë se qysh ta zinin Jesunë në grackë me fjalë. Edhe i dërguan dishepujt' e tyre me Herodianët, edhe i thanë: "Mesonjës, e dimë që je i drejtë, dhe tregon udhën e vërtetë të Perëndisë, dhe nukë mban nonjë hatër, dhe nukë ia ke frikën askujt. Thua jna, pra, si e mejton? A është e udhës t' i japim vergji Kesarit apo jo?" Po Jesuj e mori vesh djallëzinë e tyre, dhe u tha: "Përse më ngisni, o hipokrite? Dëftemëni monedhën e vergjisë." Dhe ata i prunë një dinar. Edhe ay i pyeti: "E kujt është kjo fytyrë dhe kjo përmishkresë?" Dhe ata iu-përgjeqnë: "E Kesarit." Ahere Jesuj u tha: "Pra, kthejini Kesarit gjërat, që janë të Kesarit, edhe Perëndisë gjërat, që janë të Perëndisë." Dhe kur e dëgjuan, u-çuditnë, dhe e lanë, dhe shkuan.

Gjithatë ditë, i arthnë Sadukenjtë, të cilët besojnë se nukë ka ngjallje, dhe e pyetnë, dhe i thanë: "Mësonjës, Moisiu tha: "Në vdektë dikush pa patur bij, i vëllaj duhet të martohet me gruan e tij, që t'i japë bij të vëllajt. Tani, kemi patur një herë shtatë vëllezër; dhe i pari, pasi u-martua vdiq; edhe meqënëqë nukë kishte bij, ia la gruan të vëllajt; gjithashtu edhe i dyti dhe i treti gjer tek i shtatti; edhe më pas nga të gjithë vdiq edhe gruaja. Në ngjalljen, pra, cili prej të shtatëve do ta marrë gruan? Se e patnë grua që të gjithë." Edhe Jesuj u-përgjeq, edhe u tha: "Jini të lajthitur, se nuk i dini Shkripturat as forcën e Perëndisë. Se në ngjalljen njerëzit as martohen as martojnë, po janë si Engjëjtë e Perëndisë në qjell. Sa për ngjalljen e të vdekurve, vallë nukë kini kënduar fjalët e Perëndisë, kur ju thotë: "Unë jam Perëndia i Abrahamit, edhe Perëndia i Isaakut, edhe Perëndia Jakobit?" Perëndia nuk është Perëndia i të vdekurve po i të gjallëve." Edhe kur i dëgjuan këto fjalë, gjindja çuditëshin për mësimin e tij.

Po Farisianët, kur dëgjuan që ua kishte mbëçelur gojën Sadukenjve, u-mblohnë prapë, dhe një ligjëtar prej tyre e pyeti, dyke e ngarë dhe dykë thënë: "Mësonjës, cila porrosi e ligjës është më e madhja?" Dhe Jesuj iu-përgjeq: "Doj-e Perëndinë me tërë zemrën, dhe me tërë shpirtin, dhe me tërë mendjen. Kjo është porrosia e parë dhe më e madhe. Dhe e dyta është kjo: Doj-e të afërmin si veten. Nga këto të dy porrosira varret e tërë ligja dhe Profetët."

Edhe Jesuj i pyeti Farisianët e mbledhur, dhe u tha: "Si mejtoheni për Krishtin? I biri i kujt është?" Dhe ata iu-përgjeqnë. "I biri i Davidit." Edhe Jesuj u tha: "Qysh, pra, Davidi i frymësuar e quan Zot, edhe

thotë, 'Zoti i tha tim-Zoti, Rri më të djathtën time gjer sa të t'i shtronj armiqtë nënë këmbë?' Posa Davidi e quan Zot, qysh munt të jetë i biri?" Dhe askush nuk i jipte dot nonjë përgjigje, dhe që atë ditë askush nukë kuxoj ta pyeste më.

Ahere Jesuj u tha dishepujve dhe gjindjes: "Shkronjësit edhe Farisianët kanë zënë vëndin e Moisiut. Pra, të gjitha sa ju thonë t'i ruani, i ruani dhe i bëni; po mos bëni ashtu, sikundër bëjnë ata; se të tjera thonë, dhe të tjera bëjnë. Se mbledhin barra të rënda që nukë mbahen, dhe ua vënë njerësve mi supet; po ata nuk i lëvizin as me gishtin. Dhe të gjitha veprat i bëjnë që t'u tregohen njerësve; se i zgjerojnë fillakteret, edhe i zgjatin çipet e robave. Edhe duan kryesinë e mësallës nëpër darkat, edhe vëndin e parë nëpër sinagojat, edhe përshëndoshjet nëpër rugët, edhe titullin Rabbi, Rabbi. Po ju mos u-quani Rabbi, se vetëm një është Zoti juaj, Krishti; dhe ju të tjerët jini vëllezër. Edhe mos quani Atë asnjë prej jush mi dhe; se vetëm një është Ati juaj, ay, që është në qjell. Edhe mos u-quani Mësonjës; se vetëm një është Mësonjësi juaj, Krishti. Edhe më i madhi juaj do të jetë shërbëtori juaj. Dhe ay, që e lartëson veten, do të përunjet; edhe ay, që e përunj veten, do të lartësohet.

Po mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se e mbyllni Mbretërinë e qjellit për njerëzit; se as ju vetë hyni, as i lini të tjerët të hyjnë. Mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se ua hani shtëpitë të vejave, edhe bëni lutje të gjata për gjepura; përandaj do të merrni një dënim më të rëndë. Mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se rrotulloni detin dhe sterenë që të bëni një proselit; edhe passi e këtheni,

e bëni bir ferri dy herë më keq se vetë. Mjerë ju, o prijës të verbër, që thoni se, 'Kur betohesh për tempullin, nuk është gjë, po kur betohesh për arin e tempullit, ahëre detyrohesh. O të marrë dhe të verbër, cili është më i math? Ari apo tempulli, i cili e shenjtëron arin? Gjithashtu thoni se, 'Kur betohesh për alltarin, nuk është gjë, por kur betohesh për dhuratën mi alltarin, ahëre detyrohesh.' O të marrë dhe të verbër, cila është më e madhe? Dhurata, apo alltari, i cili e shenjtëron dhuratën? Pra, ay, që betohet për alltarin, betohet për alltarin vetë dhe për të gjitha sa janë mi alltarin. Edhe ay, që betohet për tempullin, bethohet për tempullin vetë dhe për atë, që banon në tempullin. Edhe ay, që betohet për qjellin, betohet për fronin e Perëndisë dhe për Perëndinë, që rri mi atë fron. Mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se jipni të dhjetën e mëndrës, të maraqes, dhe të qimerit; edhe lini mënjane gjërat më të rënda të ligjës, gjyqin, dhe mëshirën, dhe besën; edhe këto duhen bërë, edhe ato nukë duhen lënë. O prijës të verbër, që shtrythni mushkonjën, dhe gëlltitni kamilen. Mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se qëroni të përjashtmen e kupës dhe të pjatës, edhe përbrënda i lini plot me rëmbime dhe lakmime. O Farisian i verbër, më parë qëroje kupën dhe pjatën përbrënda, dhe pastaj përjashta. Mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se u shëmbëlleni varreve të lyer me këlqere, që duken të bukur përjashta, po përbrënda janë plot me eshtra dhe me kufoma. Kështu edhe ju u dukeni të drejtë njerësve përjashta, po përbrënda jini plot me hipokrisi dhe paudhësi. Mjerë ju, o Shkronjës dhe Farisianë hipokritë, se ndërtoni varret e Profetëve, dhe stolisni monumentat e të drëjtëve, dhe thoni, 'Po të rronim në ditët e atërve tanë, nukë do të

merrnim pjesë në vrasjet e Profetëve.' Ahere dëshmoni vetë, që jini bijtë e atyre, që kanë vrrarë Profetët. Pra, mbusheni masën e atërve tuaj. O gjerpërinj, o soj nëpërkash, qysh do të shpëtoni nga dënimi i ferrit? Përandaj, ja ku ju dërgonj të tjerë Profetë dhe të urtë dhe shkronjës; edhe ju prapë do t'i vrisni, dhe do t'i kryqësoni, dhe do t'i rrihni nëpër sinagojat, edhe do t'i ndiqni nga qyteti në qytet; edhe kështu do tju bjerë mi kokë gjaku i gjithë të drejtëve, që është derdhur mi dhe, që nga gjaku i Abelit të drejtë gjer në gjakun e Zakarisë, të birit të Barakisë, të cilin e vratë midis tempullit edhe alltarit. Me të vërtetë po ju them, të gjitha këto do të bien mi kokën e këti brezi. O Jerusalem, o Jerusalem, që i vret Profetët, edhe i lapidon të dërguarit, sa herë kam dashur t'i përmbledh bijtë e tu, siç i përmbledh pula zoqtë nënë krahët, edhe nukë deshtë. Shikoni tani se qysh u-shkretua shtëpia juaj. Se ja ku ju them: Nukë do më shikoni që tani gjer sa të thoni, I bekuar është ay, që vjen më emrin e Zotit."

KORI: Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

Pastaj Psalmi 51 pa zë, dhe Litanja e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri

PRIFTI: Se ti je Mbreti i paqes dhe Shpëtimtari i shpirteve tona, dhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shënjtë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

Pastaj thuhet Shkurtorja, Shtëpia, dhe Sinaksari:

SHKURTORJA, T. II

PAS TA ANO ZITON

O shpirti im kujto, se gjyqi i përfundmë vjen, dhe

je në rezik, të pritesh si i thati fik; pra punoje hirin tënt, që të dha i Madhi Zot me dhëmpshëri, vigjëllo edhe thirr me zë: Mos rrini përjashta nusërores Jesujt.

SHTEPIA

Përse fle o shpirti im i mjerë? Përse mejtohesh për gjëra të kotta? Ora e funtme afrohet, edhe do të largohemi së këtejmi; po sa është kohë zgjohu dhe thirr: Kam bërë faj o Shpëtimtar; mos më pre si fikun e thatë, po kij mëshirë për mua o Krisht, që po thërres me frikë: Mos rrini përjashta nusërores Jesujt.

SINAKSARI

Të Martën e Madhe të Shenjtë, kujtojmë parabollën e të Dhjetë Virgjëreshave prej Ungjillit të Shenjtë.

O Dhëntërr Jesu Krisht, nëmëro-më me Virgjëreshat e urta, radhit-më me grigjën e zgjedhur, dhe mëshirona. Amin.

Pastaj Dhjaku thotë:

DHJAKU: Hyjlindësen dhe Mëmën e dritës me hymne nderimi le ta madhështojmë.

Vallet këndojnë Këngën IX të Kanunit, dhe Prifti temjanis.

KENGA IX

T. II. Bota e tërë nuk e nxë, Perëndinë Zotin Krisht, po në gji e pate si birin tënt; të hymnojmë, Shën Mari Virgjëreshë.

Nxënësit sot i këshillon, vigjëlloni ti u the: se më ç' orë vjen Shpëtimtari Krisht, nuk e dini, t'i gjykonjë të gjithë.

Kur të na vish të na gjykosh, Perëndi o Zoti Krisht, vër-më më të djathtën e fronit tënt, edhe fal-m'i të gjitha mëkatat.

ZBRITESORJA IX

Bota e tërë nuk e nxë, Perëndinë Zotin Krisht, po në gji e pate si birin tënt; të hymnojmë, Shën Mari Virgjëreshë.

Pastaj Litania e Vogël:

DHJAKU: Përsëri dhe përsëri, më paqe le t'i lutemi Zotit.

PRIFTI. Se ty të këndojnë të gjitha Forcat e qjellit, edhe ty të dërgojmë lavdi, Atit edhe Birit edhe Shpirtit të Shentjë, tani dhe përherë dhe në jetët e jetëve.

DERGIMESORJA, T. III

PAS EPESKEPPSATO IMAS

Nusëronen tënde shoh, o Shpëtimtar të stolisur, edhe robë nukë kam, edhe s' kuxonj të hynj n' atë; ndriço-ma pra stolin' o Zot, dhe prit-më dhe shpëto-më, midis të gëzuarve. (3 herë)

LAVDERIMET, T. I.

Këndohen katër, dyke i përsëritur që të dyja:

Qysh të hynj në pallatin e Shenjtorëve, unë pavyeri! Se nukë kam robë prej dasme, dhe më nxierin jashtë Engjëjtë. Paqëso-ma shpirtin o Zot, dhe shpëto-më si njeridashës.

Më zuri gjumi i ngathësisë, o Dhëntërr Jesu Krisht, edhe nukë kam llambadhe virtutash, që të dal dhe të të pres. Mos më ler jashtë, po qas-më brënda me Virgjëre-

shat e mënçura, ku gëzohen kremtonjësit, edhe thërresin pa reshtur: O Zot, lavdi më ty.

LAVDI DHE TANI, T. IV.

Dëgjoje dënimin e ati, që e varrosi talentin o shpirt, edhe mos e fshih fjalën e Perëndisë, po lëçit-i çuditë e tij, që ta rritësh dhuratën, dhe të hysh në gëzimin e Zotit tënt.

Pastaj Doksollgja e Madhe, dhe Litania e Gjatë.

PASVARGJET, T. T. I.

Ejani o besnikë, le të punojmë dhe le ta rritim, pasurinë që na ka dhënë Zoti, sicili pas fuqisë dhe dhuratës, kush me urtësinë e mëndjes, kush me veprat e mira, kush me predikimin e fjalës, që ta trashëgojmë gëzimin zotëror, për të cilin vlerësona o Krisht, o Perëndi njeridashës.

Kur të vish me lavdi, me Forcat ëngjëllore, dhe të rrish mi fronin e gjykatësit, mos më vër nga ana e mëngjër, o Bari i mirë, po radhit-më nga ana e djathtë, dhe shpëto-më si njeridashës.

O Dhëntërr i bukur, që na ftove në dasmën shpirtërore, kij mëshirë për ne që jemi shëmtuar, nga pasionet edhe mëkatat, edhe qas-na në sofrën e Mbretërisë sate, si i mirë dhe njeridashës.

LAVDI DHE TANI, T. R.

Ja ku ta dha talentin, Zoti o shpirti im; merr-e dhuratën me frikë, këtheja prapë ati që ta fali, përndajua të varfërve, dhe fitoje miqësinë e Krishtit, që të rrish më të djathtë, dhe ta trashëgoosh gëzimin zotëror, për të cilin vlerëso-me, o Zot i mëshirave.

Pastaj vazhdon dhe mbaron si Shërbesa e Dhëntërrri I.

MESHA E PARESHENJTERUAR

*Të Martën e Madhe në mëngjës bëhet Mesha e Parëshenj-
tëruar sipas Uratores, f. 149-178, gjer në Thirrtoret:*

THIRRTORET, T. I.

Këndohen dhjetë, dyke përsëritur katër të parat.

Qysh të hynj në pallatin e Shenjtorëve, unë i pavyeri? Se nukë kam robë rej dasme, dhe më nxierin jashtë Engjëjtë. Paqëso-ma shpirtin o Zot, dhe shpëto-më si njeridashës. (2 herë)

Më zuri gjumi i ngathësisë, o Dhëntërr Jesu Krisht, edhe nukë kam llambadhe virtutash, që të dal dhe të të pres. Mos më ler jashtë, po qas-më brënda me Virgjëreshat e mënçura, ku gëzohen kremtonjësit, edhe thërresin pa reshtur: O Zot, lavdi më ty. (2 herë)

Dëgjoje dënimin e ati që e varrosi talentin o shpirt, edhe mos e fshih fjalën e Perëndisë, po lëçit-i çuditë e tij, që ta rritësh dhuratën, dhe të hysh në gëzimin e Zotit tënt. (2 herë)

Ejani o beshnikë, le të punojmë dhe le ta rritim, pasurinë që na ka dhënë Zoti, sicili pas fuqisë dhe dhuaratës, kush me urtësinë e mëndjes, kush me veprat e mira, kush me predikimin e fjalës, që ta trashëgojmë gëzimin zotëror, për të cilin vlerësona o Krisht, o Perëndi njeridashës. (2 here)

O Dhëntërr i bukur, që na ftove në dasmën shpirtërore, kij mëshirë për ne që jemi shëmtuar, nga pasionet edhe mëkatat, edhe qas-na në sofrën e Mbretërisë sate, si i mirë dhe njeridashës.

LAVDI DHE TANI, T. R. Ja ku ta dha talentin, Zoti o shpirti im; merr-e dhuratën me frikë, këtheja prapë ati që ta fali, përndajua të varfërve, që të rrih më të djathtë, dhe të trashëgosh gëzimin zotëror, për të cilin vlerëso-më, o Zot i mëshirave.

Pastaj bëhet Hyrja me Ungjillin.

DHJAKU: Urtësi, o të drejtë.

KORI: Dritë gazmore. . . .

Pas Parëvargut edhe këndimeve nga Dhjata e Vjetër:

DJAKU: Urdhëro, o Atë.

PRIFTI: Urtësi, o të drejtë; Drita e Krishtit u ndrit të gjithëve.

Pastaj Prifti këndon një herë, dhe Kori dy herë në T. I:

KATEFTHINTHITO I PROSEFKHI MU

Le të drejtohet posi temjani, lutja ime sot, përpara teje; duart' i ngre përpjetë, për mbrëmë si për kurban. (3 herë)

Pastaj këndohet prej Dhjakut:

UNGJILLI PAS MATTHEUT

Zoti u tha dishepujve: Për atë ditë dhe për atë orë nukë di gjë askush, as Engjëjtë e qjellit, po vetëm im-Atë. Edhe sikundër ishte puna e ditëve të Noes, ashtu do të jetë edhe ardhja e Birit të njeriut. Se sikundër, në ditët përpara përmbytjes, njerëzit hanin dhe pinin, martonin dhe martohëshin gjer më ditën, që hyri Noja në arkë, dhe nukë muarnë vesh asgjë gjer sa ardhja përmbytja, dhe i rrëmbeu të gjithë,

gjithashtu do të jetë edhe ardhja e Birit të njeriut. Ahere nga dy burra, që punojnë në arë, njëri merret, edhe tjetri lihet; edhe nga dy gra, që bluajnë në mulli, njëra merret, edhe tjetra lihet. Pra, vigjëlloni, se nukë dini se më ç' orë ju vjen Zoti. Po këtë e dini që, po të kishte lajmë i zoti i shtëpisë se më ç' kohë vijnë vjdhësit, do të vigjëllonte, dhe do mos i linte tja çponin shtëpinë. Përandaj edhe ju bëhuni gati, se më një orë, që nuk e pandehni, ju vjen i Biri i njeriut. Ahere ku është ay kujdestar besnik dhe i mënçim, të cilin i zoti e ka vënë mi shërbëtorët e vetë, që tu japë të ngrënë më kohë? Lum' ay shërbëtor, të cilin i zoti vjen edhe e gjen më të mbaruar detyrën. Me të vërtetë po ju them, se i zoti do ta vërë qeveritar mi tërë mallin e vetë. Po nëqoftëse kujdestari del i keq, edhe thotë më vete, 'Im-zot u-vonua', edhe nis t'i rrahë shokët shërbëtorë, dhe të hanjë dhe të pinjë me të dehurit, i zoti i ati kujdestari do të vinjë më një ditë dhe më një orë të papritur, dhe do ta hedhë jashtë atë kujdestar, dhe do ta vërë në çipin e hipokritëve; atje do të jetë qarja dhe kërcëllimi i dhëmbëve.

Ahere Mbretëria e qjellit do të shëmbëllenjë me dhjetë virgjëresha, të cilat muarnë llambat e tyre, dhe duallnë për të pritur Dhëntërrin. Dhe pesë prej këtyre ishin të mënçime, dhe pesë të marra. Ato të marrat, kur muarnë llambat, nukë muarnë vaj me vete; po të mënçimet, bashkë me llambat, muarnë edhe vaj nër enët e tyre. Dhe meqënëqë Dhëntërrin vonoj, i zuri gjumi të gjitha, dhe po flinin. Dhe në mes të natës, u-dëgjua një klithmë: "Ja se ku vjen Dhëntërrin, dilni ta prisni." Ahere u-ngritnë të gjitha virgjëreshat, edhe ndreqnë llambat e tyre. Dhe të marrat u thanë të mënçimeve: "Na jepni ca nga vaji juaj, se na u-shuan

llambat." Po të mënçimet u-përgjeqnë dhe u thanë: "Jo, se nukë kemi mjaft për ne dhe për ju, po më mirë shkoni atje ku shesin vaj, dhe blini për veten tuaj." Dhe kur ato shkuan për të blerë, ardhin Dhëntërrin; dhe ato, që ishin gati, hynë bashkë me atë në dasmë; dhe dera u-mbyll. Pastaj arthnë edhe virgëreshat e tjera, dyke thënë: "O Zot, o Zot, hapna derën." Po ay u-përgjeq, edhe u tha: "Me të vërtetë po ju them që nukë ju njoh." Pra, vigjëlloni, se nukë dini as ditën as orën, në të cilën vjen i Biri i njeriut.

Se Mbretëria e qjellit i shëmbëllen një njeriu, i cili shkonte në mërgim, edhe i thirri shërbëtorët, edhe ua dorëzoi gjënë e vetë; edhe kujt i dha pesë talenta, kujt i dha dy, kujt i dha një, sicilit pas fuqisë tij; edhe shkoj menjëherë në mërgim. Edhe ay, i cili mori të pesë talentat, vajti, i punoj, edhe fitoj pesë talenta të tjera. Gjithashtu edhe ay, i cili mori të dy talentat, fitoj edhe dy të tjera. Po ay, i cili mori një, shkoj, edhe mihu, edhe e fshehu argjendin e të zotit në dhe. Edhe pas disa kohe u-këthye i zoti i atyre shërbëtorëve, edhe bëri llogari me ata. Edhe ardhin ay, i cili kishte marrë të pesë talentat, edhe solli pesë talenta të tjera, dhe tha: "Zot, më ke dhënë pesë talenta; ja ku fitova edhe pesë të tjera mi ato." Edhe i zoti i tha: "Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik! Më të pakat u-rrëfeve besnik, mi të shumta do të vëndos. Hyr në gazin e zotit tënt." Pastaj ardhin ay, i cili kishte marrë të dy talentat, edhe tha; "Zot, më ke dhënë dy talenta; ja ku fitova edhe dy të tjera mi ato." Edhe i zoti i tha: "Të lumtë, shërbëtor i mirë dhe besnik! Më të pakat u-rrëfeve besnik, mi të shumta do të vëndos. Hyr në gazin e zotit tënt." Më në funt, ardhin edhe ay, i cili

kishte marrë një talent, edhe tha: “Zot, e dinja që je njeri i zëmërgurtë, që kor atje, ku nukë ke mbjellur, edhe mbleth atje, ku nukë ke përndarë, edhe u-trëmbe, edhe shkova, edhe e fsheha talentin në dhe; ja ku ta solla prapë.” Edhe i zoti u-përgjeq, edhe i tha: “Shërbëtor i lik edhe përtac, posa e dinje që kor atje, ku nukë kam mbjellur, edhe mbleth atje, ku nukë kam përndarë, ahëre duhej ta kishe vënë talentin tim në bankë, dhe kur të këthehështa ta merrnja prapë tok me fajdenë. Pra, merrjani talentin, edhe epjani ati, i cili ka të dhjetë talentat. Se ati, i cili ka, do t’ i jipen edhe do t’ i tepërojnë; po ati, i cili nukë ka, do t’ i merret edhe ajo që kishte. Dhe hidheni shërbëtorin e padobishim në errësirën më të thellë; atje do të jetë qarja dhe kërcëllimi i dhëmbëve.”

Edhe kur të vinjë i Biri i njeriut me lavdi me gjithë Engjëjtë, ahëre do të rrinjë mi fronin e lavdisë. Dhe do të mblidhen të gjithë kombet përpara ati, edhe do t’ i ndanjë njërin nga tjatri, siç i ndan bariu dhëntë nga dhitë, dhe do t’ i vërë dhëntë më të djathtë, dhe dhitë më të mëngjër. Ahëre Mbreti do tu thotë atyre më të djathtë: “Ejani, ju të bekuarit e tim-Ati, trashëgojeni Mbretërinë, e cila u-gatit për ju që prej nisjes së botës. Se pata uri, dhe më dhatë të ha; pata etje, dhe më dhatë të pi; isha i huaj, dhe më përmblothë; isha i çveshur, dhe më veshtë; isha i sëmure, dhe më vizituar; isha në burk, dhe arthë tek unë.” Ahëre do t’ i përgjigjen të drejtët, edhe do t’ i thonë: “Zot, kur të pamë të urët, edhe të ushqyem; a me etje, dhe të vaditme; dhe kur të pamë të huaj, dhe të përmblothme; a të çveshur, dhe të veshmë; dhe kur të pamë të sëmure a në burk, dhe të vizituam?” Edhe

Mbreti do tu përgjigjet, edhe do t’ u thotë: “Me të vërtetë po ju them: Atë, që ia kini bërë njërit prej këtyre vëllezërve të mi më të vegjël, ma kini bërë mua.” Pastaj do t’ u thotë atyre më të mëngjër: “Shkoni, ju të mallkuar, lark meje në zjarrin e ameshuar, i cili u-gatit për djallin dhe engjëjtë e tij. Se pata uri, dhe nukë më dhatë të ha; pata etje, dhe nukë më dhatë të pi; isha i huaj, dhe nukë më përmblothë; isha i çveshur, dhe nukë më veshtë; isha i sëmure dhe në burk, edhe nukë më vizituar.” Ahëre do t’ i përgjigjen edhe ata, dhe do t’ i thonë: “Zot, kur të pamë të urët, a me etje, a të huaj, a të çveshur, a të sëmure, a në burk, dhe nukë të shërbyem?” Ahëre do t’ u përgjigjet, edhe do t’ u thotë: “Me të vërtetë po ju them. Atë, që nukë ia kini bërë njërit prej këtyre më të vegjëlve, nukë ma kini bërë as mua.” Edhe këta do të shkojnë në Ferrin e ameshuar, dhe të drejtët në jetën e ameshuar.

Dhe Jesuj, pasi i mbarroj të gjitha këto fjalë, u tha dishepujve: “E dini që pas dy ditësh është Pashka, dhe i Biri i njeriut tradhëtohet për të kryqësuar.”

KORI: Lavdi më ty, o Zot, lavdi më ty.

Pastaj vazhdon Mesha e Dhuratave të Parëshenj-tëruara.